

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E premte, 16 dhjetor 2022

2 [Shqiptimi i Aktgjykimit]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi. Mirë se erdhët.

8 Përpara se të fillojmë, do t'u jap fotografëve mundësinë
9 për të bërë disa fotografi.

10 Ju lutem, vazhdoni. Faleminderit.

11 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

12 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
13 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i
14 Specializuar kundër Salih Mustafës.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

16 Faleminderit.

17 Së pari, do t'u kërkoj palëve të prezantohen.

18 Z. Prokuror, ju lutem kush është i pranishëm nga Zyra e
19 Prokurorit të Specializuar.

20 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
21 Gjykatës. Prokuroria sot përfaqësohet nga z. Alex Whiting,
22 ushtrues i detyrës së Prokurorit të Specializuar; Prokurorët
23 Silvia D'Ascoli dhe Filippo De Minicis; Menaxheria e Lëndës
24 Julie Mann; dhe unë jam Cezary Michalczuk.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 2

1 Mbrojtësja e Viktimave,

2 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve.

3 Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Viktimat pjesëmarrëse

4 përfaqësohen nga Jack Provan, që është ndihmës ligjor; Anne

5 Brechtjes Vossenberq, si bashkëmbrojtëse, dhe unë, Anni PUES.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mbrojtja, ju lutem prezantohuni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve në këtë

9 sallë dhe jashtë saj. Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius

10 Von Bone; bashkëmbrojtësi Betim Shala; hetuesi dhe përkthyesi

11 Fatmir Pelaj dhe Salih Mustafa, i akuzuari.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

13 ju lutem Zyra Administrative.

14 Z. NILSSON: [Përkthim] Unë jam Jonas Nilsson, shef i

15 Shërbimeve Gjyqësore, që përfaqësoj Zyrën Administrative.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi

17 Gjyqësor I do të shqiptojë sot aktgjykimin në çështjen

18 gjyqësore Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës.

19 Trupi Gjyqësor përbëhet nga gjykatësit Roland Dekkers, Gilbert

20 Bitti dhe Vladimir Mikula si gjykatës rezervë dhe unë, Mappie

21 Veldt-Foglia si Kryegjykatëse.

22 Ky aktgjykim shqiptohet publikisht në emër të popullit të

23 Kosovës dhe në praninë e z. Mustafa.

24 Ndonëse do të lexoj përmbledhjen e konstatimeve kryesore

25 të Trupit Gjyqësor, kjo përmbledhje nuk është pjesë e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 3

1 aktgjykimit, i cili është i vetmi version autoritativ i
2 vendimit dhe konstatimeve të Trupit Gjykses. Përmbledhja që
3 nuk është version autoritativ do të jetë e disponueshme në
4 faqen e internetit të Dhomave të Specializuara.

5 Ky proces gjyqësor ka të bëjë me veprimet e z. Mustafa në
6 një kompleks në Zllash në Kosovë afërsisht midis 1 prillit
7 1999 dhe fundit të prillit 1999. Aktgjykimi i sotshëm shënon
8 një moment të rëndësishëm për Dhomat e Specializuara. Ai është
9 aktgjykimi i parë për krime lufte i kësaj Gjykate. Dhe është
10 një hap më tej për vendosjen e drejtësisë dhe vënien para
11 përgjegjësisë për shkelje të rënda të së drejtës humanitare
12 dhe penale ndërkombëtare që pretendohet se u krye në Kosovë
13 midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit të vitit 2000.

14 Përpara sesa të kaloj tek konstatimet e veta në lidhje me
15 akuzat e ngritura kundër z. Mustafa, Trupi Gjykses dëshiron që
16 të trajtojë disa aspekte të rëndësishme.

17 Së pari, duket se ka konceptime të gabuara se këto akuza
18 u ngritën kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo të gjithë
19 popullit të Kosovës. Nuk ka asgjë më larg së vërtetës se kjo.
20 Ishte pikërisht populli i Kosovës, përmes kuvendit, që zgjodhi
21 të krijonte dhe t'i jepte kompetenca këtij institucioni.

22 Gjithashtu, përgjegjësia penale para Dhomave të
23 Specializuara është vetëm individuale. Ky parim mishërohet në
24 kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. Ajo u jep
25 juridiksion Dhomave të Specializuara vetëm mbi persona fizik.

1 Në këtë çështje gjyqësore, akuzat e paraqitura nga Prokurori i
2 Specializuar kanë të bëjnë vetëm me përgjegjësinë penale
3 individuale të z. Mustafa dhe pjesëmarrjen e tij në krimet e
4 luftës të ndalimit arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe
5 vrasjes së paligjshme të paraqitura në aktakuzën e Prokurorit
6 të Specializuar.

7 Në asnjë moment nuk u gjykua UÇK-ja. Z. Mustafa dhe
8 veprimet e pretenduara të tij ishin ato që u gjykan.

9 Së dyti, viktimat që pretendohet se pësuan dëm si pasojë
10 e veprimeve të z. Mustafa janë qytetarë të Kosovës dhe të
11 përkatësisë etnike shqiptare. Përpjekjet e tyre për të kërkuar
12 drejtësinë dhe të vërtetën janë thelbi i këtij procesi.

13 Së fundi, Trupi Gjykses ka dëgjuar disa dëshmi të dorës
14 së parë nga dëshmitarë, disa nga ata janë gjithashtu edhe
15 viktima pjesëmarrëse në këtë proces. Këta dëshmitarë dëshmuan
16 për ngjarje traumatike që përjetuan dhe ndikimin e vazhdueshëm
17 psikologjik të këtyre ngjarjeve në jetën e tyre dhe të
18 familjeve të tyre.

19 Trupi Gjykses është i vetëdijshëm se duhet guxim i
20 jashtëzakonshëm për të dhënë dëshmi. Viktimat e bënë këtë në
21 një atmosferë të përhapur të frikës dhe të frikësimit që
22 vazhdon në Kosovë edhe sot e kësaj dite.

23 Gjatë gjithë gjykimit, Trupi Gjykses dëgjoji dëshmi nga
24 një numër dëshmitarësh të cilët bënë të ditur se ata që
25 bashkëpunojnë apo që besohet se bashkëpunojnë me Dhomat e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 5

1 Specializuara ose Zyrën e Prokurorit të Specializuar
2 etiketohen në Kosovë si tradhtarë apo bashkëpunëtorë dhe janë
3 objekt i kërcënimeve dhe i frikësimit, goftë ata vetë ose
4 fëmijët e tyre.

5 Viktimat që u paraqitën si dëshmitarë në këtë çështje
6 gjyqësore tani jetojnë në frikë të vazhdueshme se diçka do t'u
7 ndodhë atyre ose familjeve të tyre. Ata edhe sot e kësaj dite
8 ende nuk janë në gjendje të flasim lirshëm për ngjarje
9 traumatike që përjetuan dhe dëmin që pësuan.

10 Kjo atmosferë e frikës dhe e frikësimit e drejtuar kundër
11 dëshmitarëve që japin dëshmi në hetimet ose në ndjekjet penale
12 të krimeve që pretendohet se janë kryer nga ish-pjesëtarë të
13 UÇK-së është një prej arsyeve për krijimin e kësaj Gjykate dhe
14 vendosjen e saj në Hagë dhe jo në Kosovë. Kjo është gjithashtu
15 arsyeja pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe Trupi Gjykses
16 caktuan masa mbrojtëse për dëshmitarë dhe për viktimat
17 pjesëmarrëse për të mbajtur të fshehtë identitetin e tyre nga
18 publiku. Identitetet e viktimave iu bënë të ditura z. Mustafa
19 dhe avokatëve të tij për të garantuar të drejtën e tij për
20 gjykim të drejtë.

21 Si rrjedhojë e masave mbrojtëse për dëshmitarët dhe
22 viktimat pjesëmarrëse, disa seanca gjyqësore ishin private,
23 pra, publiku nuk mund të dëgjonte se çfarë diskutohej në
24 sallën e gjyqit. Kjo garantoj mbrojtjen e efektshme të
25 identiteteve të atyre që donin të dëshmoni për përjetimet e

1 tyre para Trupit Gjykses. Për të njëjtën arsye, Trupi Gjykses
2 urdhëroi dhe veçimin e përkohshëm të z. Mustafa dhe disa
3 kufizime të komunikimeve të tij me jashtë.

4 Trupi Gjykses, megjithatë, u ka kushtuar gjithmonë
5 vëmendje të drejtave të z. Mustafa dhe çdo herë ka balancuar
6 interesat e dëshmitarëve dhe viktimave nga njëra anë dhe të
7 drejtave të z. Mustafa nga ana tjetër.

8 Tani do të filloj me një përmbledhje të aktgjykimit. Do
9 të filloj me të akuzuarin dhe akuzat.

10 Z. Salih Mustafa, i akuzuari në këtë çështje gjyqësore,
11 është shtetas i Kosovës i lindur më 1 janar 1972 në Prishtinë,
12 Kosovë. Sipas akuzave të paraqitura nga Prokurori i
13 Specializuar dhe të konfirmuara nga Gjykatësi i Procedurës
14 Paraprake, gjatë gjithë kohës që ka lidhje me Aktakuzën e
15 Konfirmuar, z. Mustafa ishte komandant i njësitit gueril BIA,
16 një njësit i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

17 Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, BIA e kishte bazën në një
18 kompleks në Zllash në rajonin e Gollakut në Kosovë.

19 Pretendohet se ky kompleks përdorej nga BIA si vendstrehim i
20 sigurtë dhe qendër ndalimi dhe marrje në pyetje. Prokurori i
21 Specializuar pretendon se krimet e paraqitura në aktakuzë u
22 kryen në këtë kompleks dhe unë do t'i referohem si kompleksi i
23 ndalimit në Zllash.

24 Prokurori i Specializuar ngriti kundër z. Mustafa katër
25 akuza për krime lufte në bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 7

1 ndalim arbitrar, Pika 1; trajtim mizor, Pika 2; torturë, Pika
2 3; dhe vrasje e paligjshme, Pika 4.

3 Prokuroria pretendoi se z. Mustafa është personalisht
4 përgjegjës sipas formave të ndryshme të përgjegjësisë penale
5 në bazë të nenit 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit për ndalimin
6 arbitrar, trajtimin mizor dhe torturimin e së paku gjashtë
7 personave në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht midis 1
8 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 dhe për vrasjen e paligjshme
9 të një personi afërsisht midis 19 prillit të po atij viti dhe
10 fundit të prillit 1999.

11 Z. Mustafa u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të
12 gjitha akuzat.

13 Do të bëj një përmbledhje të shkurtër të procesit të
14 gjykimit.

15 Gjykimi filloi më 15 shtator 2021 me deklaratat hyrëse të
16 Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtëses së
17 Viktimave. Mbrojtja e bëri deklaratën hyrëse më 22 mars 2022.

18 Gjatë gjykimit, Trupi Gjykues dëgjoi 28 dëshmitarë, 13 të
19 thirrur nga Prokurori i Specializuar dhe 15 nga Mbrojtja.
20 Trupi Gjykues, gjithashtu, shqyrtoi deklaratat me shkrim, prova
21 shkresore dhe aktekspertiza. Për më tepër, tetë viktimat morën
22 pjesë në proces dhe të gjithë ishin nën masa mbrojtëse.

23 Pas seancës së deklaratave përmbyllëse, Kryegjykatësja
24 mbylli gjykimin e çështjes më 15 shtator 2022 dhe Trupi
25 Gjykues filloi kuvendimet e periudhës prej 90-ditësh në

1 përputhje me rregullin 159(1) të Rregullores.

2 Tani t'i kthehem si i vlerësoi provat e paraqitura nga
3 Prokurori i Specializuar dhe nga Mbrojtja në këtë çështje.

4 Para se të nxirrte konstatimet e veta faktike dhe
5 ligjore, Trupi Gjykues kreu një vlerësim të përgjithshëm të
6 besueshmërisë dhe mbështetshmërisë në dëshmitarët e Prokurorit
7 të Specializuar dhe Mbrojtjes. Trupi Gjykues gjithashtu mori
8 parasysh ndikimin e atmosferës mbizotëruese të frikësimit të
9 dëshmitarëve mbi dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

10 Në lidhje me dëshmitarët e Prokurorit të Specializuar,
11 Trupi Gjykues konstatoi se dëshmitë e tyre në masë të madhe
12 ishin të qarta, koherente dhe përputhëse, përshkrimet që bënë
13 ishin të gjalla, të hollësishme dhe të rrëfyera me emocion. Po
14 kështu, dëshmitë e dëshmitarëve konfirmuan njëra-tjetrën dhe u
15 konfirmuan dhe nga prova të tjera të besueshme dhe të
16 mbështetshme që iu paraqitën Trupi Gjykues.

17 Në tërësi, Trupi Gjykues konstatoi se dëshmitë e
18 dëshmitarëve të thirrur nga Prokurori i Specializuar ishin të
19 besueshme dhe u mbështet në to edhe pse në masa të ndryshme.

20 Në lidhje me dëshmitarët e Mbrojtjes.

21 Trupi Gjykues veçoi disa faktorë që ndikuan negativisht
22 në besueshmërinë e tyre. Ndër këta faktorë ishin lidhjet e
23 forta dhe të ngushta midis dëshmitarëve dhe z. Mustafa, që
24 buronin nga raporti vartës-epror gjatë kohës kur ishin në
25 njësitin BIA në vitin 1999 dhe marrëdhëniet personale midis

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 9

1 tyre, miq apo lidhje familjare; komunikimet e afërta ndërmjet
2 dëshmitarëve dhe z. Mustafa para dhe pas intervistave të tyre
3 me Prokurorin e Specializuar; shprehjet e fuqishme të
4 mosbesimit ose anshmërisë në rrjetet sociale kundër proceseve
5 gjyqësore para Dhomave të Specializuara; dhe ngurrimi i disa
6 dëshmitarëve për të dhënë informacion për njësitin BIA dhe për
7 të pranuar se kishin lidhje me ndonjë veprimtari të BIA-s.

8 Gjithashtu, Trupi Gjykses mori parasysh gatishmërinë e
9 disa dëshmitarëve të caktuar të Mbrojtjes për t'i përshtatur
10 dëshmitë e tyre me ato të dëshmitarëve të tjerë në favor të z.
11 Mustafa. Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve rrjedhimisht u
12 shqyrtuan me kujdesin më të madh. Gjithashtu, disa dëshmitarë
13 të Mbrojtjes nuk kishin njohuritë e duhura që Trupi Gjykses të
14 mbështetej në to. Në disa raste të tjera, dëshmitë e tyre në
15 thelb nuk lidheshin me akuzat dhe rrjedhimisht Trupi Gjykses
16 nuk u mbështet në to.

17 Së fundi, Trupi Gjykses konstatoi se shumë dëshmitarë e
18 kishin të vështirë të mbanin mend datat e sakta ose kishin
19 probleme me kujtesën. Disa nga këta dëshmitarë u thirrën nga
20 Mbrojtja për të dëshmuar lidhur me një alibi të mundshme.
21 Trupi Gjykses mori parasysh vështirësitë sistematike në
22 mbajtjen mend të datave si një faktor me gjasë ndikues në
23 mbështetshmërinë e dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve kur
24 vlerësoi alibinë e paraqitur nga Mbrojtja.

25 Tani do të flas për rolin e z. Mustafa.

1 Tani do të paraqes një përmbledhje të shkurtër të
2 konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me rolin e z. Mustafa
3 në UÇK në kohën që mbulon Aktakuza e Konfirmuar.

4 Trupi Gjykses konstatoi se në maj 1998 z. Mustafa u
5 emërua komandant i njësitit të porsaformuar BIA. Njësi BIA
6 ishte pjesë e UÇK-së. Z. Mustafa e mbajti këtë post afërsisht
7 deri nga mesi i qershorit 1999, kur BIA u shpërnda. Z. Mustafa
8 njihej me nofkën Cali dhe atë gjithashtu e thërrisnin
9 komandant Cali. Sikurse deklaroi edhe vetë z. Mustafa dhe e
10 konfirmuar nga prova të shumta, ai ishte komandanti i
11 përgjithshëm dhe i vetëm i BIA-s gjatë gjithë kohës së
12 ekzistencës së BIA-s, duke përfshirë edhe në prill të vitit
13 1999 dhe ishte gjithashtu përgjegjës për grumbullimin e të
14 dhënave të zbulimit. Z. Mustafa kishte kompetencë të bënte
15 emërimet për njësitin e BIA-s, t'ju jepte urdhra vartësve të
16 vet dhe t'i disiplinonte.

17 Para se të kaloj në konstatimet e Trupit Gjykses në
18 lidhje me krimet e paraqitura në aktakuzë do të bëjë një
19 përmbledhje të konstatimeve që kanë të bëjnë me alibinë.

20 Mbrojtja parashtroi se z. Mustafa nuk mund t'i kishte
21 kryer krimet e paraqitura në aktakuzë. Ajo pretendoi se gjatë
22 periudhës që përkon me këto akuza, z. Mustafa ishte në vende
23 të tjera dhe jo në kompleksin e ndalimit në Zllash. Trupi
24 Gjykses analizoi me kujdes provat në tërësi dhe konstatoi se
25 këto prova nuk vërtetohnin dyshim të arsyeshëm në lidhje me

1 praninë e z. Mustafa në vendin e krimit. Konkretisht, Trupi
2 Gjykues konstatoi se provat lidhur me alibinë ishin në
3 përgjithësi të mjegullta ose mospërputhëse, sidomos kur
4 krahasohen provat përputhëse të shumta që tregojnë se z.
5 Mustafa ishte i pranishëm në vendin e krimit në periudhat
6 përkatëse. Për më tepër, prova të besueshme dhe konfirmuese,
7 ndër të tjera edhe vetë nga z. Mustafa, treguan se ai ishte në
8 gjendje të lëvizte nëpër territorin përreth Zllashit dhe, në
9 fakt, e bëri këtë rregullisht gjatë prillit të 1999.

10 Tani po u kthehem konstatimeve të Trupit Gjykues lidhur
11 me krimet e paraqitura në Aktakuzën e Konfirmuar.

12 Do të fillojmë me Pikën 1, lidhur me ndalimin arbitrar.

13 Nga tërësia e provave, Trupi Gjykues konstatoi se të
14 paktën gjashtë personave iu hoq liria afërsisht midis 1
15 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999 në kompleksin e ndalimit në
16 Zllash. Viktimat u arrestuan nga anëtarë të BIA-s ose ushtarët
17 e tjerë të UÇK-së në vende të ndryshme përreth Zllashit. Më
18 tej ata iu dorëzuan anëtarëve të BIA-s në kompleksin e
19 ndalimit në Zllash. Provat vërtetojnë qartësisht se kompleksi
20 i ndalimit në Zllash kontrollohej vetëm nga BIA dhe komandanti
21 i saj z. Mustafa.

22 Trupi Gjykues konstatoi se në asnjë çast gjatë mbajtjes
23 në ndalim viktimave nuk iu dhanë garanci procedurale bazë të
24 detyrueshme për zbatim sipas të drejtës humanitare
25 ndërkombëtare për persona të cilëve iu hiqet liria.

1 Konkretisht, ata nuk u informuan për arsyet e heqjes së
2 lirisë, nuk u nxorën para një gjykatësi apo ndonjë autoriteti
3 tjetër kompetent dhe nuk iu dha mundësia të kundërshtonin
4 ligjshmërinë e mbajtjes në ndalim.

5 Gjithashtu, provat vërtetuan se z. Mustafa ishte i
6 pranishëm në kompleksin e ndalimit në Zllash disa herë gjatë
7 prillit 1999. Këtu përfshihej momenti kur një nga viktimat iu
8 dorëzua anëtarëve të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash
9 në fillim të prillit si dhe herë të tjera gjatë dy javëve të
10 para të prillit 1999. Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se z.
11 Mustafa i urdhëroi vartësit e tij të BIA-s t'i kthenin të
12 ndaluarit në vendin ku mbaheshin pasi ishin marrë në pyetje.
13 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa qëllimisht
14 u hoqi lirinë viktimave dhe e dinte se atyre nuk iu dha asnjë
15 garanci bazë gjatë gjithë periudhës së ndalimit të tyre.

16 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstatoi se Prokurori i
17 Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se u
18 krye krimi i luftës i ndalimit arbitrar i Pikës 1, kundër të
19 paktën gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash
20 afërsisht midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

21 Tani do të kaloj në Pikat 2 dhe 3 që kanë të bëjnë me
22 trajtimin mizor dhe torturën.

23 Trupi Gjykses konstatoi se të ndaluarit e kompleksit të
24 ndalimit në Zllash u mbajtën në kushte çnjerëzore dhe
25 poshtëruese të ndalimit. Ata u mbajtën në ahure të bagëtive,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 13

1 në kushte të mjerueshme, në mes të bajgave të bagëtive. Ata
2 flinin në tokë, në pellgje uji, mbi kashtë. Në ahur, ishte
3 gjithmonë terr. Të ndaluarit nuk kishin ushqim të mjaftueshëm.
4 Dëshmitarët dëshmuar se kalonin dy a tri ditë pa ngrënë. Të
5 ndaluarit gjithashtu nuk kishin ujë të mjaftueshëm dhe kur
6 kërkuan ujë, ushtarët e BIA-s urinuan mbi ta duke thënë "Qe
7 uji". Ata lejoheshin të shkonin në nevojtoare shumë rrallë dhe
8 detyroheshin t'i kryenin nevojat personale në ahur në një kovë
9 në prani të njeri-tjetrit. Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi
10 se të ndaluarve iu refuzua ndihma mjekësore dhe nuk lejoheshin
11 të flisnin me njeri-tjetrin duke u kërcënuar me vdekje.

12 Gjithashtu, provat tregojnë se z. Mustafa dhe vartësit e
13 tij të BIA-s në kompleksin e ndalimit në Zllash rregullisht i
14 keqtrajtuar të ndaluarit fizikisht dhe psiqikisht. Anëtarët e
15 BIA-s kishin një *modus operandi* të tyre. Në ahuret ku
16 mbaheshin, viktimat goditeshin me shqelma, me grushte dhe
17 shuplaka çdo ditë. Gjithashtu, anëtarët e BIA-s i nxirrnin të
18 ndaluarit nga ahuret një nga një dhe i dërgonin më të shumtën
19 e kohës në një dhomë që ndodhej mbi njërin prej ahureve ku i
20 merrnin në pyetje ashpërsisht dhe i rrihnin brutalisht.

21 Të ndaluarit u rrahën, shpesh nga disa anëtarë të BIA-s
22 njëherësh. U goditën me shkop bejzbolli, shufra hekuri, shkop
23 gome. U dogjën, u vunë nën rrymë, u shpuan me thikë, u
24 shkelmuan, u goditën me grushte dhe shuplaka.

25 Ata u morën në pyetje ashpërsisht dhe u akuzuan si

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 14

1 spiunë, bashkëpunëtorë të serbëve, tradhtarë, hajdutë ose
2 gënjeshtarë. Ata u urdhëruan të shprehnin mbështetjen për UÇK-
3 në dhe u detyruan të bërtisnin "Vdekje tradhtarëve, vdekje
4 hajnave dhe lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", siç kujton
5 një dëshmitar.

6 Keqtrajtimet u shkaktuan të ndaluarve lëndime të rënda,
7 ata u mavijosën, u mbuluan me gjak, nuk ishin në gjendje të
8 ngriheshin në këmbë apo të flisnin dhe nganjëherë humbën
9 ndjenjat. Një i ndaluar, viktima e vrasjes së paligjshme të
10 pretenduar, u keqtrajtua aq rëndë saqë ishte pothuajse i
11 vdekur. Një dëshmitar tha, në mënyrë domethënëse që tregon
12 vuajtjet e skajshme që kishte kaluar, se më mirë ta kishin
13 vrarë.

14 Vetë z. Mustafa mori në pyetje dhe keqtrajtoi dy nga të
15 ndaluarit në raste të ndryshme. Njërin prej tyre bëri sikur do
16 ta ekzekutonte. Gjithashtu atë e goditi në mënyrë të
17 përsëritur në çdo pjesë të trupit. Z. Mustafa gjithashtu
18 urdhëroi vartësit e tij ta rrihnin njërin prej të ndaluarve
19 derisa humbi ndjenjat si dhe ishte i pranishëm herë të tjera
20 kur të ndaluarit u keqtrajtuuan nga vartësit e tij të BIA-s.

21 Të ndaluarit u keqtrajtuuan edhe psiqikisht nga anëtarët e
22 BIA-s. Nga ahuret ku mbaheshin ata shihnin dhe dëgjonin të
23 ndaluarit e tjerë kur rriheshin dhe i shihnin lëndimet që
24 kishin pësuar. Për pasojë, ata jetonin me frikën e vazhdueshme
25 se do t'u vinte radha. Një dëshmitar tha "Ke ndi zëna, për

1 shembull, ke ndi zënat e njerëzve t'u bë si qen, si macja.
2 Prej torturës, prej dhimbjeve". Një tjetër shpjegoi se këto
3 dëgjoheshin pothuajse çdo natë dhe nuk mund të flinin. Dëshmia
4 e një dëshmitari flet vetë lidhur me ngarkesën e
5 jashtëzakonshme psikologjike: "Ke nejt ke pritun kush po vjen
6 me të rreh ose me të marr me të çu nalt", "je ndier shumë keq,
7 ke prit veç vdekjen, por kur po të vjen. Sot, nesër. Kur po të
8 mytin".

9 Keqtrajtimi fizik dhe psikologjik bashkë me kushtet
10 çnjerëzore dhe poshtëruese të ndalimit u shkaktuan të
11 ndaluarve lëndime të përhershme fizike dhe psikologjike.

12 Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa dhe vartësit e tij
13 të BIA-s qëllimisht u shkaktuan dhimbje dhe vuajtje të mëdha
14 fizike e mendore të paktën gjashtë personave të ndaluar në
15 kompleksin e ndalimit në Zllash me synimin e marrjes së
16 informatave ose deklaratave pranuese duke i ndëshkuar,
17 frikësuar, shtrënguar viktimat dhe/ose duke i diskriminuar ata
18 për arsye politike.

19 Duke marrë parasysh keqtrajtimin që vuajtën viktimat në
20 tërësi, Trupi Gjykses, rrjedhimisht konstatoi se Prokurori i
21 Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se
22 krimi i luftës i torturës në Pikën 3 u krye ndaj së paku
23 gjashtë personave në kompleksin e ndalimit në Zllash afërsisht
24 midis 1 prillit 1999 dhe 19 prillit 1999.

25 Trupi Gjykses gjykoi se akuza e trajtimit mizor mbulohej

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 16

1 tërësisht nga akuza e torturës dhe, rrjedhimisht, vendosi të
2 mos e shqyrtonte atë më tej, kjo u bë për hir të drejtësisë
3 për z. Mustafa.

4 Dhe tani do të kaloj në Pikën 4, vrasje e paligjshme.

5 Trupi Gjykues vërtetoi se më 19 prill apo rreth kësaj
6 date 1999, në kontekstin e ofensivës serbe që filloi në zonën
7 përreth Zllashit, anëtarët e BIA-s nën autoritetin e z.
8 Mustafa si komandant i tyre, liruan disa nga të ndaluarit e
9 kompleksit të ndalimit në Zllash. Ata gjithashtu evakuan
10 objektet e këtij kompleksi. Megjithëkëtë dhe pavarësisht nga
11 rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara nga ofensiva, Trupi
12 Gjykues konstatoi se dy të ndaluar nuk u liruan nga vartësit e
13 z. Mustafa në BIA, vartës të tij. Këta të ndaluar, jo
14 rastësisht, sipas vlerësimit të provave nga Trupi Gjykues,
15 ishin dy nga më të keqtrajtuarit. Njëri u pa për herë të
16 fundit nga të ndaluarit e tjerë pothuajse i vdekur, duke mos
17 qenë në gjendje të lëvizte. Më pas u gjet i vdekur. Trupi
18 Gjykues konstatoi se identiteti i kufomës së viktimës u
19 vërtetua në bazë të tërësisë së dëshmimeve, dokumenteve dhe
20 fotografive se ishte një prej dy të ndaluarve që nuk u liruan
21 nga kompleksi i ndalimit në Zllash.

22 Duke pasur parasysh se z. Mustafa ishte komandant i
23 përgjithshëm dhe i vetmi i BIA-s, që kishte kontroll të plotë
24 mbi kompleksin e ndalimit në Zllash, Trupi Gjykues konstaton
25 se përfundimi i vetëm i arsyeshëm është se z. Mustafa vendosi

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 17

1 të lironte disa nga të ndaluarit dhe të mbante viktimën e
2 vrasjes së paligjshme në ndalim. Këto vendime të marra nga z.
3 Mustafa në cilësinë e tij si komandant i BIA-s dhe në
4 kontekstin e ofensivës serbe që po afrohej, faktikisht ishte
5 barabar me vendimin për vrasjen e viktimës së vrasjes së
6 paligjshme duke qenë se në atë fazë atij u mohua çdo mundësi
7 për të mbijetuar.

8 Trupi Gjykses konstatoi se viktima e vrasjes së
9 paligjshme vdiq afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të
10 prillit 1999. Shkaqet e vdekjes ishin keqtrajtimi i rëndë i
11 shkaktuar nga anëtarët e BIA-s të cilët e mbajtën të ndaluar
12 për rreth tre javë, refuzim i ndihmës mjekësore nga anëtarë të
13 BIA-s dhe disa plagë me armë zjarri që u gjetën në trup.
14 Provat vërtetuan pa asnjë dyshim se dy shkaqet e para të
15 vdekjes, konkretisht, keqtrajtimi i skajshëm i viktimës së
16 vrasjes së paligjshme dhe refuzimi i ndihmës mjekësore, janë
17 tërësisht rezultat i veprimeve dhe i mosveprimeve të z.
18 Mustafa dhe vartësve të tij në BIA në kompleksin e ndalimit në
19 Zllash.

20 Sa i takon shkakut të tretë të vdekjes, gjegjësisht,
21 plagëve me armë zjarri, ndonëse përfundimi më me gjasë ishte
22 se anëtarët e BIA-s qëlluan me plumba viktimën e vrasjes së
23 paligjshme përpara se të largoheshin nga kompleksi i ndalimit
24 në Zllash, ky nuk ishte i vetmi përfundim i arsyeshëm bazuar
25 në tërësinë e provave. Ekziston, në fakt, dyshimi i arsyeshëm

1 nëse plagët me armë zjarri që u identifikuan në trupin e
2 viktimës së vrasjes së paligjshme mund t'i atribuoheshin
3 anëtarëve të BIA-s apo forcave serbe për arsyet që shpjegohen
4 me hollësi në aktgjykim. Megjithatë, Trupi Gjykues nxori
5 përfundimin se ky dyshim i arsyeshëm nuk pati ndikim në
6 atribuimin e vdekjes së viktimës z. Mustafa. Kjo sepse
7 keqtrajtimi i skajshëm i viktimës së vrasjes së paligjshme, së
8 bashku me refuzimin e ndihmës mjekësore, në kontekstin e
9 vendimeve të z. Mustafa si komandant i BIA-s që viktimë të mos
10 lirohej e të mos evakuohej kur forcat serbe iu afruan zonës,
11 përbënin shkaqe thelbësore të vdekjes së viktimës, pavarësisht
12 nëse viktimë u godit me një apo me më shumë plumba serbe.

13 Me fjalë të tjera, Trupi Gjykues gjykoi se të shtënat me
14 armë zjarri drejtpërdrejt ndaj viktimës apo vënia e tij në
15 pozitën që të qëllohej nga forcat serbe që po afroheshin, duke
16 e braktisur pambrojtje në prag të vdekjes në kompleksin e
17 ndalimit në Zllash, çon në saktësisht në të njëjtin përfundim.
18 Ky përfundim është që vdekja e viktimës mund t'i atribuohet
19 veprimeve dhe mosveprimeve të z. Mustafa si komandant i BIA-s.

20 Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstatoi se z. Mustafa
21 kishte synim ta vriste viktimën e vrasjes së paligjshme.

22 Trupi Gjykues, rrjedhimisht, konstatoi se Prokurori i
23 Specializuar ka vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se
24 krimi i luftës i vrasjes së paligjshme në Pikën 4 u krye
25 kundër një personi në kompleksin e ndalimit në Zllash

1 afërsisht midis 19 prillit 1999 dhe fundit të prillit 1999.

2 Tani do të trajtoj konfliktin e armatosur.

3 Trupi Gjykses konstatoi më tej se krimet e paraqitura në
4 aktakuzë u kryen në kontekstin e një konflikti të armatosur jo
5 ndërkombëtar midis UÇK-së dhe forcave serbe. Z. Mustafa ishte
6 në dijeni të rrethanave që vërtetojnë ekzistencën e konfliktit
7 të armatosur jo ndërkombëtar. Gjithashtu, ishte në dijeni të
8 statusit të viktimave si persona që nuk merrnin pjesë aktive
9 në veprime luftarake, duke qenë se u ishte hequr liria në
10 kompleksin e ndalimit në Zllash nën kontrollin e tij.

11 Më lejoni tani t'i kthehem natyrës së pjesëmarrjes së tij
12 në veprimet për të cilat akuzohet.

13 Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa keqtrajtoi
14 drejtpërdrejt dhe personalisht dy të ndaluar. Në lidhje me
15 këtë, Trupi Gjykses e gjykoi të përshtatshme që këtë sjellje
16 ta trajtonte në kuadër të kryerjes së drejtpërdrejtë si formë
17 e përgjegjësisë penale. Arsyja është se z. Mustafa synonte të
18 përfshihej në atë sjellje, ndër të tjera dhe me qëllimet
19 përkatëse të torturës si krim lufte.

20 Sa u takon krimeve të tjera, z. Mustafa së bashku me
21 vartësit e tij të BIA-s dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së, kishte
22 qëllimin e përbashkët që të ndalonin dhe keqtrajtonin të
23 ndaluarit e mbajtur nga BIA në kompleksin e ndalimit në Zllash
24 dhe të mbanin në ndalim, të keqtrajtonin dhe përfundimisht të
25 vrisnin viktimën e vrasjes së paligjshme.

1 Trupi Gjykses konstatoi se z. Mustafa dha një numër
2 kontributesh të qenësishme në realizimin e qëllimit të
3 përbashkët. Dhe veçanërisht, ai dha kontribut të madh në
4 realizimin e qëllimit të përbashkët si komandant i BIA-s. Ai
5 personalisht torturoi dy të ndaluar, duke u dhënë kështu
6 shembull apo nxitje vartësve të tij të BIA-s që të kryenin
7 veprime të ngjashme kundër të ndaluarve në kompleksin e
8 ndalimit në Zllash. Ai urdhëroi vartësit e tij të BIA-s që t'i
9 torturonin disa të ndaluar dhe t'i kthenin në ahuret ku
10 mbaheshin. Ai u refuzoi ndihmë mjekësore të ndaluarve
11 pavarësisht nga keqtrajtimi dhe lëndimet e tyre. Ai nuk i
12 liroi të ndaluarit, duke lejuar kështu që vartësit e tij të
13 BIA-s t'i keqtrajtonin, derisa ndodhi një ndryshim i
14 jashtëzakonshëm në rrethana, konkretisht, ofensiva serbe. Dhe
15 asnjëherë nuk e liroi apo evakuo viktimën e vrasjes së
16 paligjshme i cili vazhdoi të ishte në ndalim kur z. Mustafa
17 dhe vartësit e tij u larguan nga kompleksi i ndalimit në
18 Zllash për shkak të afrimit të ofensivës serbe.

19 Bazuar nga sa më lart, Trupi Gjykses konstaton se z.
20 Mustafa ka përgjegjësi penale si kryes i drejtpërdrejtë i
21 krimit të luftës së torturës në Pikën 3, vetëm për incidentet
22 kundër dy të ndaluarve në të cilat z. Mustafa mori pjesë
23 personalisht.

24 Trupi Gjykses konstaton gjithashtu se z. Mustafa ka
25 përgjegjësi penale përmes kontributit të tij të qenësishëm në

1 një ndërmarrje kriminale të përbashkët për krimin e luftës të
2 ndalimit arbitrar Pika 1; dhe torturës, Pika 3, kundër më së
3 paku gjashtë të ndaluarve; si dhe për krimin e luftës së
4 vrasjes së paligjshme, Pika 4, kundër një të ndaluari.

5 Lidhur me dënimin.

6 Para shqiptimit të vendimit dhe të dënimit, do të bëj një
7 përmbledhje të shkurtër të qëllimeve të dënimit dhe të
8 faktorëve të shqyrtuar nga Trupi Gjykses në përcaktimin e
9 dënimit të përshtatshëm për veprat penale për të cilat z.
10 Mustafa është penalisht përgjegjës.

11 Përpara se ta bëj këtë, Trupi Gjykses dëshiron të
12 informojë se më pas do të lëshojë një urdhër për zhdëmtim në
13 bazë të neneve 22(8) dhe nenit 44, paragrafi 6 të ligjit dhe
14 ruan juridiksionin e nevojshëm në lidhje me këtë.

15 Trupi Gjykses rikujton se ndëshkimi dhe parandalimi janë
16 ndër qëllimet kryesore të dënimit të individëve të shpallur
17 fajtorë për vepra penale.

18 Gjithashtu, Trupi Gjykses dëshiron të theksojë rëndësinë
19 e nxjerrjes para drejtësisë të kryesve të krimeve të rënda që
20 janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare në tërësi për t'i
21 dhënë fund mosndëshkimit edhe dekada pas ngjarjeve në fjalë
22 dhe pavarësisht nga ekzistenca prej kohësh e atmosferës
23 mbizotëruese të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë.

24 Një qëllim tjetër i rëndësishëm i dënimit është njohja e
25 dëmit dhe vuajtjeve që iu janë shkaktuar viktimave dhe

1 shoqërisë.

2 Së fundi, Trupi Gjykses thekson se krimet në këtë çështje
3 u kryen vetëm kundër shqiptarëve kosovarë. Trupi Gjykses është
4 gjithashtu i mendimit se zbulimi i së vërtetës si rezultat i
5 këtij aktgjykimi mund të kontribuojë më tej në pajtimin
6 ndërmjet grupeve të prekura në Kosovë për të kontribuar në
7 rivendosjen dhe ruajtjen e paqes.

8 Trupi Gjykses shqyrtoi peshën e krimeve dhe të pasojave
9 të tyre, kontributin personal të z. Mustafa në ato krime,
10 rrethanat personale të personit të shpallur fajtor dhe
11 rrethanat lehtësuese dhe rënduese si faktorë të rëndësishëm
12 për përcaktimin e dënimit të përshtatshëm.

13 Për sa i takon peshës së krimeve, Trupi Gjykses gjykoi se
14 ndalimi arbitrar është i rëndë sepse i bën viktimat të
15 cenueshme ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut;
16 tortura përfaqëson cenim të dinjitetit, sigurisë dhe
17 mirëqenies mendore dhe fizike të njeriut; dhe vrasja e
18 paligjshme është vetiu një nga krimet më të rënda.

19 Në këtë çështje të paktën gjashtë të ndaluarve iu hoq
20 liria në kompleksin e ndalimit në Zllash, në kushte çnjerëzore
21 dhe poshtëruese, pa asnjë garanci bazë dhe ata rregullisht u
22 keqtrajtuuan psiqikisht dhe fizikisht. Për më tepër, një i
23 ndaluar vdiq si rezultat i keqtrajtimit të rëndë të shkaktuar
24 nga anëtarë të BIA-s të cilët u mbajtën në ndalim për pothuaj
25 tre javë, u refuzua ndihma mjekësore nga anëtarë të BIA-s dhe

1 plagë nga armë zjarri të gjetura në trup, në lidhje me të
2 cilat Trupi Gjykses konstatoi se ekziston dyshimi i arsyeshëm
3 nëse mund t'ju atribuohen anëtarëve të BIA-s ose të forcave
4 serbe. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykses nuk e merr parasysh
5 shkakun e fundit të vdekjes në përcaktimin e dënimit.

6 Sa u takon pasojave të krimeve, Trupi Gjykses mbajti
7 parasysh se viktimat në këtë çështje gjyqësore vuajtën nga
8 lëndime afatgjata si fizike ashtu edhe mendore. Gjithashtu
9 përjetuan pasoja negative në marrëdhëniet personale dhe jetën
10 familjare. Më tej disa patën dhe e kanë të vështirë të fitojnë
11 jetesën. Trupi Gjykses mori gjithashtu parasysh ndikimin e
12 vrasjes së paligjshme jo vetëm tek viktima e drejtpërdrejtë
13 dhe ata që ishin dëshmitarë të keqtrajtimit të tij, por dhe
14 tek anëtarët e familjes së viktimës.

15 Trupi Gjykses gjithashtu mori parasysh dy rrethana
16 rënduese, konkretisht, siç u përshkrua më lart, se tortura u
17 krye me egërsi të veçantë dhe viktimat ishin veçanërisht të
18 cenueshme apo të pambrojtura, duke pasur parasysh statusin,
19 izolimin dhe në disa raste, moshën e re të tyre. Njëri prej
20 tyre, për shembull, ishte 18 vjeç.

21 Për këto arsye, Trupi Gjykses vlerësoi se pesha e krimeve
22 të shqyrtuara ishte e rëndë.

23 Sa i përket kontributit personal të z. Mustafa në këto
24 krime, Trupi Gjykses mbajti parasysh pozitën eprore dhe rolin
25 qendror të z. Mustafa në një sistem ndalimesh të paligjshme

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Shqiptimi i Aktgjykimit (Seancë e hapur)

Faqe 24

1 dhe torturash në kompleksin e ndalimit në Zllash, së bashku me
2 miratimin dhe mbështetjen në vijimësi prej tij të të njëjtave
3 veprime në periudhën midis ose rreth 1 prillit 1999 dhe 19
4 prillit 1999.

5 Trupi Gjykses gjithashtu mbajti parasysh se z. Mustafa
6 personalisht dhe qëllimisht i torturoi dy prej të ndaluarve.

7 Më tej, Trupi Gjykses gjykoi se z. Mustafa kishte synimin
8 e trajtimit vdekjeprurës që u bë viktimës së vrasjes së
9 paligjshme dhe që ai keqtrajtoi të vazhdonte përrreth 19 ditë,
10 ndërkohë që refuzoi ndihmë mjekësore, garanci bazë ose lirimi
11 që ishte në kompetencë të tij ta bënte si komandant i BIA-s.
12 Përfundimisht z. Mustafa, në cilësinë e tij si komandant i
13 BIA-s, vendosi të mos e lironte viktimën e vrasjes së
14 paligjshme, çka, faktikisht, ishte e barabar me vendim për
15 vrasjen e tij.

16 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses vlerësoi shkallën e
17 kontributit personal të z. Mustafa në krimet e shqyrtuara si
18 dhe synimin e tij si shumë të lartë.

19 Së fundi, Trupi Gjykses nuk u dha peshë të konsiderueshme
20 rrethanave personale të z. Mustafa, duke e pasur parasysh
21 llojin dhe peshën e krimeve të vërtetuara dhe kontributin e
22 tij në to.

23 Tani do të shqiptoj vendimin.

24 Z. Salih Mustafa, ju lutem ngrihuni në këmbë.

25 Në emër --

1 Z. Mustafa, doni t'i mbani dëgjueset?

2 Në emër të popullit të Kosovës, për arsyet e shtjelluara
3 në aktgjykim dhe të përmbledhura më lart dhe duke marrë
4 parasysh të gjitha provat dhe argumentet e palëve dhe
5 mbrojtësve të viktimave, Trupi Gjykses në bazë të neneve 43
6 dhe 44 të Ligjit dhe rregullave 158, 159, 163 dhe 165 të
7 Rregullores, ju shpall ju, z. Mustafa, fajtor për:

8 Pikën 3, torturë si krim lufte, sipas neneve 14,
9 paragrafi 1, pika c dhe i dhe neneve 16(1)(a) të Ligjit,
10 kryerje e drejtpërdrejtë;

11 Pikën 1, ndalim arbitrar si krim lufte, sipas neneve
12 14(1)(c) dhe 16(1)(a) të Ligjit, si pjesë e ndërmarrjes
13 kriminale të përbashkët në formën bazë të saj;

14 Për Pikën 3, torturë si krim lufte sipas neneve
15 14(1)(c)(i) dhe 16(1)(a) të Ligjit, si pjesë e ndërmarrjes
16 kriminale të përbashkët në formën bazë të saj;

17 Pikën 4, vrasje e paligjshme si krim lufte, në bazë të
18 nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit, si pjesë e ndërmarrjes kriminale
19 të përbashkët në formën bazë të saj.

20 Trupi Gjykses ju shpall të pafajshëm për krimin e luftës
21 së trajtimit mizor në Pikën 2.

22 Tani do të shqiptoj dënimin.

23 Z. Mustafa, duke qenë se jeni shpallur fajtor për më
24 shumë se një vepër penale, Trupi Gjykses ka përcaktuar nga një
25 dënim më vete për secilën vepër penale për të cilën është

1 dhënë vendim fajësie në bazë të rregullit 163(4) të
2 Rregullores. Së pari do të jap këto dënime më vete e më pas do
3 të shqiptoj dënimin e njehsuar për sjelljen tuaj kriminale në
4 tërësi.

5 Trupi Gjykues ka përcaktuar dënim me 10 vjet burgim për
6 krimin e luftës së ndalimit arbitrar, Pika 1; dënim me 22 vjet
7 burgim për krimin e luftës së torturës, Pika 3; dhe dënim me
8 25 vjet burgim për krimin e luftës së vrasjes së paligjshme,
9 Pika 4.

10 Trupi Gjykues ju dënon me vendim të njësuar me 26 vjet
11 burgim në të cilën llogaritet koha e kaluar në paraburgim.

12 Z. Mustafa, mund të uleni.

13 Zyra Administrative tani do të shpërndajë aktgjykimin në
14 formë elektronike.

15 Ju lutem vazhdoni.

16 Një kopje e legalizuar e versionit në gjuhën angleze do
17 t'i jepet z. Mustafa sa më shpejt sot, versioni në gjuhën
18 shqipe do t'ju jepet pasi të jetë gati.

19 Trupi Gjykues do të nxjerrë një version të redaktuar
20 publik të aktgjykimit më pas. Trupi Gjykues kujton se ruan
21 juridiksion në këtë çështje, në lidhje me lëshimin më pas të
22 urdhrit për zhdëmtim ku do të specifikohet kompensimi i
23 përshtatshëm për viktimat ose në lidhje me ta në pajtim me
24 nenet 22(8) dhe 44(6) të Ligjit.

25 Para mbylljes së seancës, Trupi Gjykues do të shqiptojë

1 dhe një urdhër gojor.

2 Trupi Gjykues gjykon se kufizimet në fuqi të kontakteve
3 dhe komunikimeve të z. Mustafa nuk janë më as të nevojshme as
4 proporcionale në këtë fazë të procesit. Rrjedhimisht, Trupi
5 Gjykues vendos t'i shfuqizojë *proprio motu* këto masa, vendim
6 që hyn në fuqi të mërkurën 21 dhjetor 2022 në mesditë. Trupi
7 Gjykues do të nxjerrë arsyet e veta me shkrim javën e ardhshme
8 në bazë të rregullit 75, paragrafi 2 të Rregullores.

9 Seanca mbyllet.

10 --- Seanca mbyllet në orën 09.49

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25